

KËRKESË

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KËRKUES: PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.
Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

BAZA LIGJORE: Nenet: 4/1, 17, 18, 41, 42/1, 43, 131/a, 134/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenet: 6/1, 14 i KEDNJ; Neni 1 Protokolli 1 i KEDNJ-së; si dhe nenet 45 dhe 49/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

I nderuar z. Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

I. HYRJE:

1.1 Në seancën plenare të datës 5 Dhjetor 2015, Kuvendi i Shqipërisë, me 78 vota ka miratuar ligjin nr.133/2014 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të

kompensimit të pronave”. Ky ligj është paraqitur për shpallje më datë 11 dhjetor 2015.

- 1.2** Presidenti i Republikës, referuar nenit 85/1 të Kushtetutës, me Dekretin nr. 9377, dt.29.12.2015 ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.
- 1.3** Komisioni i Ligjeve, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 19 Janar 2016 ka marrë në shqyrtim Dekretin nr.9377, dt.29.12.2015 të Presidentit të Republikës, duke e votuar ‘kundër’ me shumicë të votave. Në seancën plenare të datës 21.01.2016, Kuvendi i Shqipërisë, ka votuar ‘kundër’ (me 71 vota), Dekretin nr.9377, dt.29.12.2015 të Presidentit të Republikës.
- 1.4** Vendimi i Kuvendit nr.1/2016, dt.21.01.2016 “Për rrëzimin e dekretit nr.9377, datë 29.12.2015, të Presidentit të Republikës, ‘Për kthimin e ligjit nr.133/2015 ‘Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave’ ” është botuar në Fletoren Zyrtare (FZ) nr.15/2016, në datë 8.02.2016¹. Ndërsa, Ligji nr.133/2015 është botuar në FZ nr.255/2015, në datë 8.02.2016². Akti është dërguar për botim në FZ nga ana e Kuvendit në datë 8.02.2016, duke kapërcyer afatin ligjor të përcaktuar në nenin 4 të ligjit 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”. Sipas nenit 39 të Ligjit nr.133/2015, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
- 1.5** Referuar Relacionit të projekt-ligjit, Qeveria ka propozuar një ligj të tillë me qëllim zgjidhjen e çështjes së pronarëve të vjetër, duke eliminuar me ligj dhe në praktikë zvarritjet burokratike, si dhe për të sjellë barazi të të gjithë ish-pronarëve të cilëve u është njohur prona për kompensim, me qëllim realizimin e një shpërblimi të drejtë, sipas kushteve ekonomike dhe sociale të shtetit, duke pretenduar të gjendet një balancë mes interesit publik dhe të drejtës së pronës. Gjithashtu, në Relacion të projekt-ligjit pretendohet se është referuar në Vendimin Pilot të GJEDNJ-së” Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, duke konkluduar me : (i) një formulë efikase dhe realiste për kompensimin e pronarëve; (ii) një afat të arsyeshëm dhe të përcaktuar kohor për përfundimin e të gjithë procesit; (iii) një zgjidhje të drejtë, duke respektuar normat kushtetuese për të gjithë pronarët, por gjithashtu edhe për të gjithë qytetarët, duke mbajtur në konsideratë interesin publik.³
- 1.6** Referuar Raportit të Komisionit të Ligjeve, nevoja për hartimin e ligjit të ri ka ardhur pasi kuadri ligjor në fuqi për kthimin dhe kompensimin e pronave është vlerësuar se është kompleks dhe jashtë realitetit të Shqipërisë.⁴ Përmes këtij Ligji (neni 2) synohet: (i) të përfundohet procesi i trajtimit të kërkesave për kthim

¹ Aneks I- Vendim 1/2016 dt.21.01.2016 i Kuvendit të Shqipërisë

² Ankes II-Ligji 133/2015 botuar në FZ nr.255/2015 datë 8.02.2016

³ AneksIII- Relacioni i Projekt-Ligjit “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, fq. 1-2.

⁴ Aneks IV-Raport i Komisionit të Ligjeve “Për projekt-ligjin ‘Per trajtimin e prones dhe perfundimin e procesit te kompensimit te pronave’– Dokument Parlamnetar, fq. 2.

kompensimin e pronës referuar ligjit 9235/2004 (të ndryshuar) të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe që akoma rezulton të mos jenë trajtuar si dhe të kërkesave të reja që do të paraqiten rishtazi pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji referuar nenit 27 të tij; (ii) të rregullohet kompensimi i pronës referuar ‘shpërblimit të drejtë’ duke ekzekutuar vendimet administrative/gjyqësore përfundimtare të kompensimit dhe përfundimin e këtij procesi sipas afatit të përcaktuar në Ligj, nëpërmjet fondit të kompensimit⁵.

- 1.7** Pavarësisht se referuar detyrimit kushtetues që kishte Shqipëria, referuar nenit 181 të Kushtetutës në vitin 2004 Kuvendi miratoi ligjin nr.9235, i cili zgjidhi çështjen e shpronësimeve dhe konfiskimeve të kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41 të Kushtetutës. Zgjidhja e cila u gjet përmes ligjit nr.9235 u vlerësua të ishte brenda standarteve ndërkombëtare, pavarësisht ndërhyrjeve të mëvonshme në legjislacion që u kontrolluan nga Gjykata Kushtetuese në vite sipas rastit. Komisioni i Venecias sipas kërkesës së Avokatit të Popullit në vitin 2004 dha vlerësim pozitiv për draft-ligjin. Problemi i konstatuar nga ana e GJEDNJ-së ka qenë pikërisht mosekzekutimi i vendimeve përfundimtare dhe mospërcaktimi i afateve kohore dhe mënyrës në të cilën do të realizohej kompensimi i pronarëve, gjë e cila ishte rekomanduar dhe nga Komisioni i Venecias. GJEDNJ përmes vendimit pilot i kërkoi shtetit Shqiptar të merrte një sërë masash me qëllim që të gjente një mjet efektiv për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore.
- 1.8** Skema e vendosur sipas ligjit të ri Për Trajtimin e Pronës, pretendon të bëjë të mundur përmbylljen e procesit të dhëniens së vendimeve për dosjet e patrajtuara nga AKKP deri më sot brenda një afati tre vjeçar; përfundimin e vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim brenda një afati tre vjeçar; përfundimin e kompensimit financiar brenda një afati dhjetë vjeçar, duke pretenduar të jetë bazuar në një parashikim buxhetor referuar vlerësimit financiar të pronave të njohura dhe për kompensim.
- 1.9** Ky Ligj pretendohet të përbëjë dhe mekanizmin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronës qoftë sa i takon trajtimin fillestar në drejtim të njohjes së pronës dhe më pas kompensimit të saj apo edhe atij të kompensimit referuar vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore që priten të ekzekutohen në të ardhmen. Përmes Ligjit të ri, përcaktohen rregulla sipas të cilave do të bëhet një vlerësim i të gjitha vendimeve përfundimtare, duke u justifikuar se nuk kanë një vlerë të përcaktuar. Ky vlerësim do të bëhet sipas llojit të pronës në momentin e shpronësimit, ndërkohë që Qeveria nuk ka patur një hartë vlere transparente që reflekton çmimin e tregut në momentin që ka draftuar dhe miratuar Ligjin, duke krijuar shkelje të standartit ndërkombëtar në këtë drejtim.

⁵ Shih neni 2 i Ligjit nr.133/2015

- 1.10** Ligji përcakton dhe rregulla në drejtim të trajtimit të dosjeve të patrajuara prej shumë vitesh. Është fakt që gjatë këtyre dy viteve është kërkuar shtyrja e afatit të funksionimit të AKKP, duke justifikuar me pamundësinë e përmbylljes së procesit të trajtimit përfundimtar të dosjeve të hapura. Ndërkohë, në më shumë se dy vite AKKP nuk ka trajtuar asnjë dosje, por ka çelur dosje të reja, ndërkohë që nuk ishte ky qëllimi i legjislatorit në vitin 2004 kur u hartua ligji. Tashmë pasi ka akumuluar një numër shumë të madh dosjesh, sipas Ligjit përcaktohet se kërkesat do të trajtohen sipas rregullave të reja, paçka se janë paraqitur shumë herët në kohë dhe sipas ligjit të mëparshëm duhet të ishin përmbyllur tashmë.
- 1.11** Përvec të tjerash ky Ligj do të zbatohet gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, për çështjet në gjykim në çdo Gjykatë, përfshirë dhe GJEDNJ-në. Në këtë mënyrë nuk janë realizuar pritshmëritë referuar Vendimit Pilot dhe për më tepër që mekanizmi i ndërtuar për të realizuar ekzekutimin e vendimeve përfundimtare jo vetëm që nuk duket të jetë efektiv, por krijon shumë probleme të tjera që çenojnë standartin e Konventës dhe të Kushtetutës së R.SH-së.
- 1.12** Sa më sipër, duke qenë se ky ligj, i cili tashmë ka hyrë në fuqi dhe cënon rëndë parime të rëndësishme si: siguria juridike, barazia para ligjit, apo të drejtat e pronësisë, rezervoj të drejtën si President i Republikës së Shqipërisë për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

II. LEGJITIMIMI I PALËVE

- 2.1** Në lidhje me legjitimitetin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, neni 134 i Kushtetutës u ka njohur disa prej organeve të larta shtetërore një pozicion të privilegjuar në raport me të tjerët, pa qenë i nevojshëm vërtetimi i ekzistencës së interesit për çështjen në shqyrtim. Kushtetuta ka pranuar se interesi i bartësve të funksionit publik siç është Presidenti i Republikës, me qëllim mbrojtjen e sistemit normativ dhe parimet shtetformuese si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj, nuk mund të kushtëzohet. Kjo e drejtë kushtetuese që i njihet Presidentit synon të mbrojë objektivisht *’jetën e shtetit dhe të së drejtës dhe jo aspekte subjektive private’*, duke realizuar në këtë mënyrë kontrollin objektiv të kushtetutshmërisë. Si rrjedhojë, Presidenti përjashtohet nga detyrimi për të provuar ekzistencën e interesit përpara Gjykatës Kushtetuese, për shkak se Kushtetuta e prezumon interesin e tij, duke e konsideruar atë përfaqësues të interesave të larta të funksionimit të shtetit dhe të mbrojtjes së interesit publik, dhe ndërhyrja e tij në këtë proces është në të mirë të kushtetutshmërisë dhe nuk i nënshtrohet ndonjë kriteri kufizues si në rastet e

kontrollit *ex post facto*, ashtu edhe kontrollin *ex ante*, pa iu nënshtruar ndonjë kufizimi.

- 2.2 Presidenti i Republikës, në rastin konkret referuar nenit 134/1/a të Kushtetutës legjitimohet për të kërkuar para Gjykatës Kushtetuese kontrollin abstrakt të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”

III. NË LIDHJE ME ANTIKUSHTETUTSHMËRINË E LIGJIT NR. 133/2015

Duke u nisur nga fakti që Ligji ka marrë përsipër të zgjidhë përfundimisht çështjen e pronës në Shqipëri, qoftë trajtimin të kërkesave fillestare, apo edhe gjetjes së mekanizmit për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe për ta bërë këtë i referohet detyrimeve të Shtetit sipas nenit 181 dhe 41 të Kushtetutës, por nga ana tjetër pretendon që të zbatojë dhe detyrat e lëna nga GJEDNJ në vendimin pilot, duke u orientuar drejt një qasje të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me konventën dhe jurisprudencën e saj, kam gjetur se ky Ligj është në shkelje të standarteve ndërkombëtare qoftë sa i takon rregullave të përcaktuara për trajtimin e çështjes së ekzekutimit të vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore, qoftë rregullave të përcaktuara në trajtimin e dosjeve të patrajuara deri në momentin e hyrjes në fuqi apo që do të paraqiten pas hyrjes në fuqi të Ligjit. Për arsytet më poshtë Ligjin e gjej antikushtetues në tërësi.

A. Shkeljet kushtetuese në rregullat e përcaktuara në Ligj në drejtim të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore.

- (i) Skema e ofruar përmes këtij Ligji për zgjidhjen e problemit sistematik dhe të përsëritur në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve në lidhje me kompensimin e pronarëve që kanë një vendim përfundimtar administrativ apo gjyqësor bie ndesh me parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe nuk është aspak efektive siç kërkohet nga GJEDNJ referuar vendimit pilot Manushaqe Puto dhe të tjerë k. Shqipërisë.***

- 3.1 Neni 181/1 i Kushtetutës përcakton se: *‘Kuvendi, brenda dy deri në tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41’*. Këtë detyrim kushtetues ka patur për qëllim legjislatori, kur në vitin 2004 ka miratuar Ligjin nr. 9235 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”. Në këto 12 vite, referuar rregullave të përcaktuara në atë ligj janë trajtuar me mijra dosje, për të cilat tashmë ekzistojnë vendime përfundimtare që duhet të ishin ekzekutuar, përveç vendimeve të mëparshme të KKKPr-ve të cilat janë finalizuar në rrugë administrative dhe

gjyqësore dhe që sipas GJEDNJ-së përbëjnë tituj ekzekutiv. Referuar Relacionit të projekt-ligjit dhe Raportit të Komisionit të Ligjeve, duket se është tentuar që sot të përmbushet detyrimi kushtetues që në fakt është zgjidhur para 12 vitesh. Shteti shqiptar ka marrë përsipër të bëjë kthimin e plotë të pronës së shpronësuar, marrë pa të drejtë gjatë rregjimit komunist dhe në rastet që ka parë të pamundur kthimin, ka marrë përsipër kompensimin në natyrë apo financiar, apo edhe forma të tjera për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Është e vërtetë që është diskrecion i shteteve dhe Konventa nuk vë detyrim kthimin, por Shqipëria zgjodhi një formulë të tillë si qasje. Shqipëria ka dështuar në procesin e kompensimit të pronarëve në rastet që kishte të pamundur kthimin dhe këtu Gjykata nuk e ka parë problemin tek kthimi i pronës, por tek problematika të tjera si në drejtim të legjislacionit të paharmonizuar, dështimin në rregjistrimin e pronave, krijimin e fondit të konsoliduar fizik, krijimit dhe konsolidimin e fondit financiar, moskoordinimin mes institucioneve që punojnë në fushën e pronave, etj.

3.2 Tregimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në vite në Relacionin shoqërues të draft-ligjit, duke filluar nga viti 1994 pas hyrjes në fuqi të ligjit 7698/1993, apo edhe të jurisprudencës pas vitit 2004, kohë kur hyri në fuqi ligji nr.9235/2004, në drejtim të detyrimit të shtetit për trajtimin e pronës referuar nenit 181 të Kushtetutës apo teoritë e interesit publik karshi të drejtës së pronës janë të ezauruara tashmë, përse kohë legjislatori bëri një zgjedhje dhe zgjidhje të caktuar. Tashmë, vendimet janë përfundimtare dhe duhet të ekzekutohen në respekt të Konventës dhe Kushtetutës. Në çështjen Ramadhi k. Shqipërisë, ashtu edhe si në shumë çështje të tjera të ngjashme, GJEDNJ ka përsëritur se: *‘Gjykata rikujton se shteti ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cili është interesi i përgjithshëm, veçanërisht kur bëhet fjalë për kompensim për shkak të shtetëzimit ose shpronësimit, duke qenë se legjislacioni i brendshëm ka një diskrecion të gjerë në zbatimin e politikave ekonomiko-shoqërore. .. Megjithatë, kjo hapësirë vlerësimi nuk është e pakufizuar dhe përdorimi i saj është objekt rishikimi nga mekanizmat e Konventës’*⁶

3.3 Në rastin Manushaqe Puto dhe të Tjerë k. Shqipërisë, Gjykata ka vlerësuar se mjeti ligjor i kërkuar nga neni 13 i Konventës duhet të jetë “efektiv” në praktikë si dhe në ligj, në kuptim ose të parandalimit të shkeljes së pretenduar ose vazhdimit të saj, ose të ofrimit të kompensimit të mjaftueshëm për çdo shkelje tashmë të ndodhur. Çështja e efektivitetit të zbatimit të vendimeve përfundimtare ose gjyqësore që i jepnin ankuesve kompensim në vend të kthimit të pronave Gjykata e ka shqyrtuar fillimisht në çështjen Ramadhi dhe të Tjerë k. Shqipërisë, ku konstatoi shkelje të nenit 13 dhe 6/1. GJEDNJ vendosi të dilte me vendim pilot për çështjet e pronave, pasi vlerësoi shkelje sistematike dhe të përsëritura në shumë raste. Objekti i përcaktimit të çështjes nga gjykata për “procedurën e gjykimit-pilot” është lehtësimi i zgjidhjes më të shpejtë dhe më efektive të një situate jofunksionale që cënon mbrojtjen e të drejtës në fjalë të Konventës në rendin juridik kombëtar. Qëllimi i procedurës së gjykimit – pilot është nxitja e Shtetit të paditur për të zgjidhur një numër të madh çështjesh individuale që lindin nga i njëjti problem strukturor në nivel të brendshëm, duke zbatuar kështu parimin e subsidiaritetit që fuqizon sistemin e Konventës.

⁶ Shih, Ramadhi Kundër Shqipërisë, nr.38222/02, dt.13.11.2007, para 79.

3.4 Në çështjen Manushaqe Puto k. Shqipërisë GJEDNJ ka orientuar palën shqiptare sa i takon masave të përgjithshme si më poshtë:

“110. Gjykata çmon se Shteti i paditur duhet të marrë masa të përgjithshme prioritare, me qëllim sigurimin në mënyrë efektive të të drejtës për kompensim ndërsa vendos balancë të drejtë midis interesave të ndryshme në fjalë (shihni, për shembull Burdov (nr. 2), të cituar më lart, § 125). Në bazë të monitorimit nga Komiteti i Ministrave, Shteti i paditur mbetet i lirë të zgjedhë mjetet me të cilat do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas Nenit 46 të Konventës, me kusht që këto mjete të jenë të pajtueshme me përfundimet e caktuara në vendimin e Gjykatës (shihni Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [GC], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, GJEDNJ 2000-VIII). Gjykata vëren fillimisht se legjislacioni aktual mbi pronësinë është ndryshuar shpesh, të paktën shtatë herë gjatë periudhës 2004-2010. Ndërsa ndryshimet legjislative mund të reflektojnë një situatë të përmirësuar, kompleksiteti i dispozitave legjislative, ndryshimet e shpeshta të tyre, si dhe praktika e papajtueshme gjyqësore që rezulton nga to, do të kontribuojë në mënyrë të pashmangshme në një mungesë të përgjithshme të sigurisë juridike. Shteti i paditur duhet të shmangë ndryshimet e shpeshta të legjislacionit dhe të shqyrtojë me kujdes të gjitha implikimet ligjore dhe financiare përpara se të paraqesë ndryshime të mëtejshme.

*111. Siç u pranua nga Qeveria në Planin e saj të Veprimit, autoritetet nuk kishin informacion të saktë dhe të besueshëm në lidhje me numrin e përgjithshëm të vendimeve administrative që njihnin të drejta të pronësisë dhe dhënien e kompensimit, sipas rastit, të cilat ishin miratuar që prej vitit 1993. **Ekzistenca e të dhënave të sakta që duhet të reflektojnë edhe ndryshimet e bëra me anë të rishikimit gjyqësor, do t'i jepte mundësinë autoriteteve të llogarisnin dhe analizonin faturën e përgjithshme të kompensimit, si dhe implikimet financiare të mekanizmit të kompensimit.***

112. Përgatitja e një baze të dhënash dhe llogaritja e faturës globale të kompensimit duhet të shoqërohet nga një skemë e qartë kompensimi e hartuar me kujdes. Skema e kompensimit e cila nuk duhet të ketë procedura të ngarkuara përputhshmërie, për shembull detyrimin që një ankues të aplikojë për kompensim në vitin e ardhshëm në rast të një kërkesë të pasuksesshme në një vit pararendës, duhet të marrë në konsideratë parimet e praktikës së Gjykatës në lidhje me zbatimin e Nenit 6 § 1 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (shihni paragrafët 90-92 më lart).

*113. Më tej, Gjykata vëren se skema e kompensimit duhet të trajtojë përfundimet e nxjerra sipas Nenit 13 të Konventës (shihni paragrafët 75-84 më lart). Në veçanti, ajo thekson ngarkesën tejet të rënduar në buxhetin e shtetit që përfaqëson kompensimi financiar. Përfundimet e mësipërme kërkojnë qartë një rishqyrtim të modaliteteve për pagesën e kompensimit financiar që zbatohet aktualisht. **Rishikimi dhe përditësimi i hartave të vlerës duhet t'i nënshtrohet kritereve transparente dhe shpjeguese, duke marrë parasysh zhvillimin e tokës dhe luhatjet e tregut. Gjykata nxit autoritetet me prioritet që të fillojnë shfrytëzimin e formave të tjera alternative të kompensimit të parashikuara nga Ligji për Pronësinë i vitit 2004, të cilat***

eventualisht do të lehtësonin presionin ndaj buxhetit dhe/ose do të paraqisnin mënyra të tjera kompensimi.

114. Procesi i vendimmarrjes për llojin e kompensimit që do të jepet kërkon transparencë dhe efikasitet maksimal, me synim rritjen e besimit të publikut. Do të ishte në interes të përgjithshëm që rezultatet të bëheshin publike dhe të shpërndareshin përmes mjeteve të ndryshme, të aksesueshme të komunikimit. Është thelbësore që vendimet e autoriteteve të përmbajnë arsye të qarta dhe të mjaftueshme dhe t'i nënshtrohen rishikimit gjyqësor në rast mosmarrëveshjeje.

115. Procesi i kompensimit të ish pronarëve për shkak të Liqjeve për Pronësinë duhet të dallohet nga kompensimi i ish pronarëve në bazë të Liqjit të Legalizimit. Në lidhje me këtë të fundit, Shteti i paditur mund të rishqyronte rritjen e pjesës së kostos që legalizimi i ka sjellë ankuesve në masën që do të ishte i aftë të rregullonte kompensimin financiar të paguar ish pronarëve. Nga ana tjetër, Shteti i paditur duhet të qarantojë ekzistencën e një sistemi transparent dhe efektiv të regjistrimit të pronave, duke përfshirë të dhëna të sakta, të unifikuara hartografike, me qëllim mundësimin, thjeshtimin dhe lehtësimin e transaksioneve të ardhshme ligjore.

116. Krejt në ndryshim nga propozimet në Planin e Veprimit të Qeverisë që nuk kishte përmendur afate konkrete, Gjykata nuk mund të theksojë mjaftueshëm rëndësinë e caktimit të afateve realiste, statute dhe detyruese në lidhje me çdo hap të procesit. Shtyrjet e shpeshta të afateve, siç ka ndodhur deri tani, nuk kontribuojnë në një zgjidhje të shpejtë të problemeve të identifikuara dhe dëmtojnë më tej besimin e publikut.

117. Është e rëndësishme që, me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të masave të përgjithshme, në dispozicion të autoriteteve kompetente të vihen burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale dhe të garantohet bashkërendimi midis institucioneve të ndryshme, me synim shkëmbimin e informacionit. Sa herë që të jetë e mundur, autoritetet mund të shqyrtojnë mundësinë e shkurtimeve të burimeve, duke bashkuar institucione të ndryshme, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe zvogëlimin e kostove dhe shpenzimeve operative. Krijimi i strukturave të reja institucionale nuk duhet të konsiderohet si një shtresë tjetër e procesit por duhet të justifikohet plotësisht.

118. Gjykata çmon se shkalla e problemit dhe masat e sugjeruara më lart, mbi një bazë tërësisht treguese, së bashku me nevojën për zgjidhje të plotë dhe praktike, mund të trajtoheshin më mirë, nëse do t'i nënshtroheshin diskutimeve të gjera publike, me qëllim grumbullimin e një perceptimi të gjerë rreth nivelit të kompensimit që Shteti pritet të paguajë realisht dhe formave të ndryshme të kompensimit. “

3.5 GJEDNJ në vendimin pilot për Shqipërinë ka vlerësuar ndër të tjera se Qeveria duhet të realizojë hartimin e një Plan-Veprimi për zbatimin e vendimit pilot që duhet

të adresojë: **(i)** Hartimi i një liste të vendimeve përfundimtare gjyqësore dhe administrative që njohin, kthejnë dhe kompensojnë të drejtën e pronës. Kjo listë duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me statusin e pronës, vendndodhjen, sipërfaqet që kthehen, kompensohen dhe format e kompensimit; **(ii)** Adoptimi i Hartës së Vlerës së Pronës me vlera sa më të arsyeshme dhe reale; **(iii)** Përgatitja e faturës financiare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; **(iv)** Fillimi i zbatimit të një skeme përfundimtare të kthimit dhe kompensimit me procedura të menduara dhe të drejta hap pas hapi; **(v)** Krijimi i mjeteve efektive të ankimit për mosëkzekutimin e vendimeve përfundimtare.

3.6 Komiteti i Ministrave për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës në mbledhjen e rradhës në 4-6 Qershor 2013 pasi shqyrtoi ecurinë e masave të përgjithshme në kuadër të vendimit pilot “*Manushaqe Puto*” që trajton problemin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare që njohin, kthejnë dhe kompensojnë pronën, doli me një Rezolutë të Ndërmjetme (CM/RESDH(2013)115)⁷, me qëllim detyrimin e Qeverisë që të merrte masa në drejtim të: **(i)** Krijimit të një mekanizmi efektiv për zgjidhjen e rasteve të pronësisë mbi bazën e vendimit pilot “*Manushaqe Puto*”; **(ii)** Raportimit të numrit të saktë zyrtar të vendimeve përfundimtare, administrative/dhe apo gjyqësore, që njohin, kthejnë dhe kompensojnë pronën; **(iii)** Raportimit të një fature financiare për shlyerjen e të gjitha vendimeve të paekzekutuara që njohin, kthejnë dhe kompensojnë pronën; **(iv)** Hartimin e një plan veprimi të ri, që të zëvendësojë plan veprimin e mëparshëm të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.350/2011. Ky plan i ri veprimi duhet të jetë koherent me zhvillimet e reja sipas përcaktimeve të bëra në vendimin pilot, për të parashikuar masa strategjike dhe afate të reja kohore për secilën prej tyre, që synojnë përmbylljen e plotë të ekzekutimit të vendimeve përfundimtare që njohin, kthejnë apo kompensojnë pronën ish pronarëve.

3.7 Qeveria përmes VKM nr.236, datë 23.04.2014 ka miratuar plan-veprimin, ku ka pretenduar të parashikojë masat e parashikuara në vendimin pilot dhe në pikën 4 të tij pretendonte të kishte krijuar mekanizmin efikas për kompensimin e pronarëve. Komiteti i Ministrave në mbledhjen e tij në Qershor 2014 mirëpriti aprovimin formal nga Këshilli i Ministrave të Plan Veprimit që përcakton masat në lidhje me vendosjen e skemës efektive të kompensimit të pronave, duke kërkuar të reduktoshin afatet kohore të përcaktuara në të⁸. Ndërsa, në Korrik të vitit 2014 GJEDNJ refuzoi kërkesën për shtyrje të Qeverisë, duke konkluduar se Plan Veprimi i aprovuar së fundi nga Qeveria nuk është i duhuri dhe se është shumë pak progres sa i takon detyrave të lëna nga Komiteti i Ministrave referuar vendimeve të tij dhe Rezolutës së Ndërmjetme të referuar më sipër.⁹ Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se

⁷ Aneks V-Rezoluta e Ndërmjetme CM/RESDH(2013)115

⁸ Aneks VI-Vendim i Komitetit të Ministrave 5 Qershor 2014- mbledhja 1201

⁹ Aneks VII-Komunimim i GJEDNJ për Qeverinë datë 4.Korrik 2014

plan-veprimi i miratuar nga Qeveria në Prill 2014, përmban të njëjtat masa sikur plan-veprimi i vitit 2011 i miratuar nga Qeveria, para se të dilte vendimi pilot dhe në këto kushte nuk përmbushte pritshmëritë e Gjykatës. Në këto kushte, GJEDNJ nuk akordoi as shtyrjen e kërkuar nga Qeveria për gjetjen e mekanizmit efikas në trajtimin e ekezekutimit të vendimeve në drejtim të kompensimit të pronave. Në vijim, Komiteti i Ministrave në mbledhjen e tij në Qershor 2015 ka vlerësuar paraqitjen e një draft-ligji të përgatitur nga Qeveria dhe i ka kërkuar autoriteteve të bëjnë një vlerësim ligjor dhe financiar në lidhje me implikimet nga skema e kompensimit e parashikuar në draft-ligj, duke e ftuar Qeverinë që të paraqesë sqarime në lidhje me komentet e bëra nga Sekretariati në lidhje me draft-ligjin referuar memorandumit (H/Exec(2015)16)¹⁰.

3.8 Nga ana tjetër GJEDNJ, ka vazhduar të mbajë të njëjtin qëndrim si në rastin Manushaqe Puto, në çështjen Karagjozi dhe të Tjerë k. Shqipërisë, duke vlerësuar se: *” .. nuk ekzistonte asnjë zgjidhje e brendshme, e cila mundëson kompensimin e duhur dhe të mjaftueshëm për moszbatimin për një kohë të gjatë të vendimeve të Komisionit të cilat akordonin kompensim.”*, dhe në vijim duke shprehur keqardhjen për progresin e kufizuar në zbatimin e vendimit pilot ka akorduar shpërblimin e drejtë për secilin nga aplikantët duke iu referuar hartës së vlerës të vitit 2008 të konsideruar të arsyeshme.¹¹

3.9 Të njëjtin qëndrim GJEDNJ ka mbajtur edhe në çështjen Siliqi dhe të Tjerët k. Shqipërisë¹² dhe Metalla dhe të Tjerë k. Shqipërisë, duke gjetur sërish se mungon një mekanizëm efektiv dhe duke bazuar shpërblimin e drejtë në hartën e vlerës së vitit 2008 dhe jo në atë të fundit të Qeverisë të vitit 2014, mbi bazën e të cilit Qeveria ka bërë dhe përllogaritjen e faturës financiare totale mbi bazën e të cilit ka ndërtuar dhe skemën e kompensimin përmes ligjit të ri të miratuar tashmë në parlament.¹³

3.10 Në vendimin më të fundit Sharra dhe të Tjerë k. Shqipërisë, GJEDNJ sërish ka gjetur shkelje të nenit 13, të Konventës përsa kohë Qeveria nuk ka ofruar një zgjidhje efektive sa i takon përzgjatjes së procedurave në zbatimin e vendimeve përfundimtare në lidhje me kompensimin e pronës.¹⁴ Në këtë rast, Qeveria është munduar të justifikojë hartën e vlerës të vitit 2014, si e rishikuar dhe e përditësuar referuar kriterëve transparente dhe shpjeguese, duke marrë në konsideratë zhvillimin e tokës dhe luhatjet e tregut.¹⁵ Gjithashtu, Qeveria ka kërkuar që aplikantët të kompensohen për llojin e pronës në momentin e shpronësimit duke e

¹⁰ AneksVIII-Vendimi i Komitetit të Ministrave Qershor 11 Qershor 2015-mbledhja 1230

¹¹ Shih Karagjozi dhe të Tjerë k. Shqipërisë, Vendim datë 8 Prill 2014, para. 52-54, 62-66.

¹² Shih Siliqi dhe të Tjerë k. Shqipërisë, datë 10 Mars 2015, para 20, 27

¹³ Shih Metalla dhe të Tjerë k. Shqipërisë, datë 16 Korrik 2015, para. 31, 37.

¹⁴ Shih Sharra dhe të Tjerë k. Shqipërisë, datë 10 Nëntor 2015, para50-51

¹⁵ Po aty, para 69-70

përllqaritur sipas hartës së vlerës të vitit 2014.¹⁶ Pavarësisht argumenteve të paraqitura nga Qeveria, GJEDNJ përfundimisht ka arritur në përfundimin se kompensimi i pronës në të tilla raste ashtue si edhe në çështjen Vrioni k. Shqipërisë, në rastet kur shteti nuk ka mundësi të kthejë pronën, njeh kompensimin e cila i korrespondon vlerës më të fundit të pronës, duke hedhur poshtë në këtë mënyrë pretendimin e Qeverisë për t’iu referuar llojit të pronës në momentin e shpronësimit.¹⁷ Gjithashtu, Gjykata ka konsideruar se kërkesat e paraqitura kohë më parë nuk mund të lloqariten referuar hartës së vlerës së vitit 2014, pasi do të krijonte një pabarazi mes palëve, ndërkohë që harta e vlerës së vitit 2014 nuk reflekton vlerën e trequt dhe në shumë qytete kryesore, në veçanti në Tiranë, harta e vlerës është ulur ndjeshëm.¹⁸ Gjykata ka gjetur të pabazuar edhe vlerësimet e bëra nga aplikantët përmes ekspertëve, përsa kohë nuk është përdorur metoda krahasuese e vlerave të transaksioneve për toka fqinje me pronën që kërkohet të kompensohet, e bazuar në dokumente mbështetëse. Në këto kushte Gjykata ka vazhduar të aplikojë hartën e vlerës të vitit 2008, të cilën e ka gjetur më të justifikuar.

3.11 Sekretariati i Komitetit të Ministrave ka bërë një shqyrtim të projekt-ligjit “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe ka kërkuar nga Qeveria që të japë përgjigje për çështjet e ngritura.¹⁹ Sekretariati ka gjetur shumë paqartësi gjatë vlerësimit të skemës së kompensimit, duke nënvizuar herë pas here rëndësinë që merr parimi i sigurisë juridike. Sekretariati ka vlerësuar se përmes kësaj skeme duhet t’i jepet një fund pasigurive dhe vështirësive të krijuara si rezultat i ndryshimeve të herë pas hershme në legjislacion dhe se e ka të pamundur të bëjë vlerësimin përfundimtar të skemës së kompensimit përsa kohë kërkohet edhe nxjerrja e akteve të tjera nënligjore.²⁰ Ndërkohë, Sekretariati ka gjetur paqartësi edhe në shqyrtimin ligjor dhe financiar të skemës së kompensimit, përsa kohë do të vazhdojnë të depozitohen kërkesa të reja dhe fatura financiare do të vijë në rritje, çfarë e bën të pasigurt prognozën e Qeverisë për të arritur kompensimin në 10 vite për të gjitha kërkesat²¹. Paqartësi, Sekretariati ka gjetur edhe në drejtim të procedurave që do të ndjekin aplikantët, përsa kohë standarti i Konventës kërkon që të mos ketë kosto dhe sorollatje.²² Sekretariati, ka gjetur paqartësi edhe sa i takon transparencës dhe efektivitetit të procesit të kompensimit të pronës përsa kohë nuk ekziston një *database* hartografik i të gjitha vendimeve dhe rregjistrimi i pronës akoma nuk ka përfunduar.²³ Paqartësi ka edhe në drejtim të procesit të kompensimit sa i takon respektimit të afateve kohore, duke pasur parasysh edhe burimet njerëzore

¹⁶ Po aty, para 71.

¹⁷ Po aty, para 80

¹⁸ Po aty, para 85-87

¹⁹ Aneks IX- Document H/ Exec(2015)16

²⁰ Po aty, para 30

²¹ Po aty, para 31

²² Po aty, para 34-35

²³ Po aty, para 36

në organin administrativ dhe në gjykata.²⁴ Sekretariati ka shprehur paqartësi edhe në lidhje me formën e kompensimit referuar nenit 8 të Ligjit, duke shfaqur dyshime në lidhje me trajtimin e pabarabartë të aplikantëve.²⁵ Dyshime hidhen edhe në lidhje me sigurinë juridike sa i takon metodologjisë së përlllogaritjes së kompensimit, ku Qeveria i referohet llojit të pronës në momentin e shpronësimit.²⁶ Sekretariati ka hedhur dyshime edhe në lidhje me afatin 10 vjeçar të vendosur nga Qeveria në lidhje me përmbylljen e procesit të kompensimit të vendimeve përfundimtare.²⁷

3.12 Përmes këtij Ligji pretendon të zgjidhë përfundimisht ekzekutimin e vendimeve përfundimtare administrative dhe gjyqësore sa i takon kompensimit të pronave, duke ofruar një skemë efektive dhe realiste. Referuar Raportimit të bërë para Sekretariatit të Komitetit të Ministrave, Qeveria këtë mekanizëm **e ka ndërtuar duke u nisur në të dhënat se ekziston një numër dosjesh, rreth 26 000, të cilave u është njohur kompensimi në një vlerë totale 155,583,016 ALL ose 1,111,307 EUR, si dhe 9000 dosje të cilat janë kërkesa të patrajtura.**²⁸ Pavarësisht kërkesave të herëpashershme të Komitetit të Ministrave, Qeveria ka dështuar të japë një shifër të saktë të vendimeve përfundimtare administrative dhe gjyqësore, duke përcaktuar dhe sipërfaqen dhe më pas faturën e saktë financiare duke iu referuar një harte vlere që reflekton çmimin e tregut. Qeveria tregon se janë 26.000 vendime, por nuk ndan sa janë vendime administrative përfundimtare, sa janë gjyqësore dhe sa janë çështje në proces. Gjithashtu, Qeveria duhet të tregonte dhe të justifikonte hartën e vlerës të përdorur për të bërë përlllogaritjen dhe të tregonte çfarë ka marrë në konsideratë kur ka arritur në përfundimin se fatura që duhet të kompensohet është 155,583,016 Lek apo 1,111,307 Euro. Kjo shifër duket të jetë e pasaktë, pavarësisht ku është bazuar Qeveria, pasi nuk mund të ndodhë që për 26.000 vendime të jetë llogaritur një vlerë aq e ulët.²⁹ Ndërkohë referuar Ligjit, parashikohet që në 10 vite Qeveria ka programuar një fond 50 miliard Lekë që do të shpërndahet në 10 vite, por që duket se nga ky fond do të bëhet edhe kompensimi i pronarëve për efekt të Ligjit të Legalizimeve. Pavarësisht se kjo nuk tregohet nga Qeveria, është e qartë se ajo zgjidh një problem pa të dhëna të sakta dhe në përfundim zgjidhja do të jetë e gabuar, pavarësisht dëshirës.

3.13 Duke u nisur nga përmbajtja e Ligjit dhe nga qëndrimi që ka mbajtur Qeveria në çështjen Sharra dhe të Tjerë k Shqipërisë, është e dukshme që Qeveria ka marrë në konsideratë llojin e pronës në momentin e shpronësimit për secilën nga dosjet si dhe hartën e vlerës të vitit 2014. Qoftë përpjekja për t'iu rikthyer llojit të tokës në vitin

²⁴ Po aty, para 37

²⁵ Po aty, para 45

²⁶ Po aty para 46-47

²⁷ Po aty 80-85

²⁸ Po aty, para13

²⁹ Referuar Raportit të Komisionit të Ligjeve, sipërfaqe totale e njohur me vendime të KKKP/AKKP është 186,823 ha toke, nga të cilat 74,420 ha kthim fizik dhe 73,400 ha kompensim. Ndërkohë nuk rezulton të ketë ndonjë faturë financiare të përlllogaritur.

1945 apo për të insistuar në kriteret jo transparente dhe aspak shpjeguese të hartës së vlerës, Qeveria është e dështuar referuar vendimit më të fundit të GJEDNJ, përsa kohë ajo ka vendosur kriterin në çështjen Vrioni k. Shqipërisë në lidhje me mënyrën e kompensimit në rast pamundësie të kthimit të pronës si dhe kriterëve në lidhje me përcaktimin e hartës së vlerës që në cdo rast duhet të reflektojë çmimin e tregut e zhveshur nga cdo barrë fiskale. Gjykata ka komunikuar me Shtetin Shqiptar përmes vendimit të saj në Nëntor 2015, kur ishte vënë në dijeni edhe të projekt-ligjit të përgatitur nga Qeveria, duke dashur ta orientojë në lidhje me hartën e vlerës së vitit 2014 që nuk ishte realiste dhe në lidhje me ri-vlerësimin e vendimeve, duke iu referuar llojit të pronës në momentin e shpronësimit. Por duket qartë që Qeveria nuk reflektoi dhe aq më tepër legjislatori.

3.14 Pra, në kushtet që Qeveria nuk ka të dhëna të sakta sa i takon vendimeve përfundimtare administrative, gjyqësore dhe përsa kohë ka marrë përsipër t'i kthehet llojit të pronës në momentin e shpronësimit, duke mos njohur zhvillimin e saj dhe luhatjet e tregut në përcaktimin e vlerës së pronës, duket qartë që edhe skema nuk i arrin pritshmëritë referuar vendimit Manushaqe Puto sipas të cilës *“112. Përgatitja e një baze të dhënash dhe llogaritja e faturës globale të kompensimit duhet të shoqërohet nga një skemë e qartë kompensimi e hartuar me kujdes..... 113. Rishikimi dhe përditësimi i hartës së vlerës duhet t'i nënshtrohet kriterëve transparente dhe shpjeguese, duke marrë parasysh zhvillimin e tokës dhe luhatjet e tregut.”* Mbetet e paqartë dhe e dyshimtë forma e kompensimit fizik referuar neneve 12,13, 14 të Ligjit, përsa kohë Qeveria ka dështuar në procesin e kompensimit fizik, qoftë edhe në rastet kur diçka e tillë është vendosur nga GJEDNJ si në rastin Budini k. Shqipërisë (çështje 37419/06) apo Hajnaj k. Shqipërisë (çështje 1504/07)³⁰. Veç të tjerash në fondin për kompensimin finaciari janë përfshirë edhe rastet e kompensimit nga ligji i legalizimit, të cilat nga ana e GJEDNJ është kërkuar që të dallohen nga fondi për kompensimin nga ligji i pronës. Ky Ligj jo vetëm që nuk bën një dallim të tillë, por në të njëjtën kohë vazhdon të krijojë një paqartësi në lidhje me Fondin e caktuar nga Qeveria për kompensimin referuar nenit 9,10,11, pasi përmes atij fondi nuk synohet të kompensohen pronarët për të ekzekutuar vendimet e tyre përfundimtare administrative apo gjyqësore referuar Ligjit të Pronës, por shërben për të kompensuar edhe pronarët që preken nga procesi i Legalizimit. Fatura në të tilla raste është tepër e lartë, duke marrë në konsideratë edhe qasjen e Qeverisë që ka prioritet legalizimin e ndërtimeve informale duke përfshirë edhe ato të ndërtuara gjatë viteve 2009-2014. Kjo është edhe përgjigja e vërtetë për Sekretariatit e Komitetit të Ministrave në lidhje me heqjen e kthimit të pronës dhe vendosjen në prioritet të kompensimit financiar nga ana e Qeverisë, pavarësisht me kosto. Sërish, kjo qasje është në kundërshtim me vlerësimin e Gjykatës në vendimin pilot.

³⁰ Shih Karagjozi dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 8.04.2015

3.15 Në nenin 15 “*Afatet e vlerësimit financiar të vendimeve për kompensim*” të Ligjit 133/2015, Qeveria ka përcaktuar një afat kohor prej tre vitesh për të bërë vlerësimin financiar për secilin subjekt i cili ka një vendim të mëparshëm përmes të cilit i njihet e drejta për kompensim. Kjo është një qasje që cënon sërish sigurinë juridike dhe për zgjat me ligj procesin e kompensimit të pronave. Pretendohet se referuar rezolutës së ndërmjetme dhe kërkesave të GJEDNJ-së përmes vendimit pilot, Qeveria ka bërë përllogaritjen e faturës financiare në lidhje me kompensimin e pronarëve që kanë një vendim përfundimtar. Karakteri i vendimeve të KKKPr-ve dhe AKKP-ve është trajtuar në çështjen Ramadhi k. Shqipërisë dhe ato përbëjnë tituj ekzekutivë, pavarësisht nëse ato vendime kanë një vlerë të caktuar apo jo. Vetë ligji i kohës ka përcaktuar se si do të bëhet kompensimi i tyre, dhe në rast të zbrazëtisë së kuadrit ligjor ka qenë GJEDNJ, e cila ka bërë edhe zgjidhjen rast pas rasti duke i orientuar Qeverinë drejt një harte vlere që reflekton çmimin e tregut. Përmes këtij Ligji, Qeveria në cdo rast pritet të nxjerrë një vendim të ri i cili është i ankimeshëm në Gjykatë sa i takon masës së kompensimit, por duke iu referuar gjithmonë hartës së vlerës të përcaktuar nga Qeveria. Pra, është e qartë se Qeveria pretendon të ketë ndërtuar mekanizmin efektiv, ndërkohë që nuk ka përgatitur faturën e plotë financiare mbi bazën e të cilës do të bazohet skema e kompensimit. Pra, kjo skemë është totalisht e paqartë dhe për më tepër e dyshimtë, çfarë do të ndikojë në për zgjatjen e procedurave të mëtejshme të kompensimit të pronarëve. Nga Qershori 2013 kur doli Rezoluta e Ndërmjetme deri më tani, Qeveria do të duhej të kishte arritur të nxirrte faturën e plotë financiare, ndërkohë që kjo Agjenci në dy vite nuk ka nxjerrë asnjë vendim sa i takon dosjeve të patrajuara duke cënuar procesin e rregullt ligjor referuar nenit 6/1 të KEDNJ-së. Sipas këtij Ligji, Agjencia është e mbrojtur nga Ligji nëse vazhdon të mos bëjë asnjë kompensim të pronarëve gjatë tre viteve. Gjithashtu, ofron pasiguri juridike në realizimin e të drejtës së kompensimit dhe shkelje të procesit të rregullt ligjor referuar vendimit Ramadhi k. Shqipërisë.

3.16 Kjo skemë është vënë në dyshim nga ana e Sekretariatit të Komitetit të Ministrave në vlerësimin e bërë nga ana e tij, ndërkohë që Komiteti i Ministrave në mbledhjen e tij më të fundit në Dhjetor 2015 i ka kërkuar Qeverisë që t’i vihen në dispozicion të gjitha aktet nënligjore për të bërë vlerësimin e plotë të efektivitetit të skemës së kompensimit të pronarëve dhe ka kërkuar nga ana e autoriteteve të bëhet sqarimi në lidhje me hartën e vlerës që do të përdoret për kompensimin e pronarëve.³¹ Për të gjitha arsyet e mësipërme, skema e kompensimit e ndërtuar sipas Ligjit 133/2015 sa i takon procesit të përfundimit të kompensimit, jo vetëm që nuk i përgjigjet kërkesave të vendimit pilot, por ndërkohë bie ndesh me vendime të tjera të GJEDNJ referuar të drejtës së pronës, si dhe bie ndesh me parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit të elaboruar nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj në vite.

³¹ Aneks X- Vendimi I Komitetit Ministrave , Dhjetor (1243)2015

(ii) Rivlerësimi i vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore në lidhje me kompensimin çënon parimin e sigurisë juridike

3.17 Në kapitullin 2 të Ligjit janë përcaktuar rregullat për kompensimin e vendimeve përfundimtare, në lidhje me metodologjinë e vlerësimit si dhe format e kompensimit dhe të vlerësimit. Këto rregulla vlejnë si për vendimet për dosjet e patrajtura, por edhe për dosjet për të cilat ka një vendim përfundimtar. Sipas Ligjit, të gjitha vendimet përfundimtare për kthim dhe kompensim prone, për përfundimin e procesit të kompensimit, do t'i nënshtrohen vlerësimit. Sipas Ligjit mënyra e vlerësimit është: (i) Prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit; (ii) Prona e kthyer vlerësohet sipas zërit kadastral aktual të saj dhe sipas zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit, duke llogaritur diferencën e vlerës, që do të rezultojë nga ndryshimi i zërit kadastral; (iii) Vendimet përfundimtare që kanë të njohur vetëm të drejtën e kompensimit do të vlerësohen sipas zërit kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit sipas përcaktimeve të mësipërme; (iv) Në rastet kur subjektet e shpronësuar kanë përfituar me vendim kthim dhe kompensim, diferenca e llogaritur si më sipër do të zbritet nga vlerësimi i vlerës së pronës së njohur për kompensim; (v) Vlerësimi për vendimin përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit duke marrë si referim zërin kadastral sipas origjinës së pronës, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet, duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastrale të njëjtë me atë të origjinës së pronës, me distancë të njëjtë dhe me vlera të ndryshme, atëherë për referim në përllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë; (vi) Në rast se ATP merr një vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet sipas pikës 1 të nenit 6. Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë se sa prona që ka patur në momentin e shpronësimit, atëherë subjekti i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së; (vii) Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimi financiar apo cdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashigimtarët e tij kanë përfituar më parë, do të zbritet nga shuma e përllogaritur për kompensim; (viii) për vendimet e kompensimit të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara, nga periudha e njohjes së të drejtës për kompensim deri në marrjen e shpërblimit, subjektet e shpronësura do të përfitojnë indeksimin sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interes bankar sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga BSH në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit. Qeveria nëpërmjet Drejtorit të Agjencisë indirekt do të shfuqizojë vendimet e KKKPR dhe AKKP të cilat janë bërë përfundimtare në pjesën sa i takon kompensimit.

- 3.18** Për të justifikuar këtë lloj mënyre të vlerësimit të përcaktuar në Ligj, në Relacionin shoqërues të draft ligjit, Qeveria i është referuar vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në vite lidhur me trajtimin e pronës dhe diskrecionin që ka shteti në këtë drejtim dhe ka elaboruar inetersin publik të vendosur karshi të drejtës së pronës, për të justifikuar ndërhyrjen e bërë. Kjo ndërhyrje cënon sigurinë juridike, por Qeveria e ka justifikuar me interesin publik. Sipas Qeverisë, vendimet nuk kanë një vlerë të përcaktuar dhe si të tillë, nuk mund të ekzekutohen. Kjo është në shkelje të standartit të vendosur nga GJEDNJ. Qeveria manipulon me vlerësimin e vendimeve, ndërkohë që përmes kësaj mënyre të vlerësimit po bën një shpronësim të ri të pronarëve.
- 3.19** Përmes këtij ligji shkelet parimi i sigurisë juridike në trajtimin e kompensimit financiar të pronës të njohura dhe të dhëna për kompensim prej vitesh, përsa kohë Qeveria synon që përmes këtij Ligji, t'i kthehet llojit të tokës në momentin e shpronësimit. Kjo do të thotë të bësh një rishikim të vendimit përfundimtar që ka kthyer kompensuar pronën. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 27, dt.26.05.2010 ka konkluduar se: *'48. Situata paraqitet ndryshe kur nje subjekt pretendon se një akt shpronësimi i cënon të drejtat e veta pasurore ose reale. Duke qënë se jemi para një interesi publik, subjekti kërkon mbrojtjen e interesit të vet të ligjshëm dhe për këtë qëllim kundërshton aktin publik, i cili ka karakteristikat e aktit administrativ.....Për pasojë Gjykata konstaton se shqyrtimi i së drejtës së pronësisë mbi një send mund të bëhet vetëm nga gjykata'*
- 3.20** Qeveria arsyeton se siguria juridike mund të kufizohet për hir të interesave publike. Në vendimin nr. 27/ 2010 Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se : *'57. Vendimet e formës së prerë nuk mund të vihen në diskutim as nga palët që kanë marrë pjesë në proces dhe as nga organet shtetërore, të cfarëdolloj natyre qofshin... Nëse vendimeve të gjykatave apo, atyre quasi gjyqësore do t'u hiqej efekti i sigurisë juridike nga cilido qoftë, nuk mund të flitej më për pushtet gjyqësor, pasi vendimi do të kishte vetëm fuqi deklarative.*
- 3.21** Referuar raportit të ligjit siguria juridike mund të kufizohet për hir të interesit publik, që do të thotë pamundësi financiare për të ekzekutuar në mënyrë të plotë të gjitha vendimet përfundimtare të kompensimit të pronës. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.02.2013 të cilit i referohet Komisioni i Ligjeve, është konkluduar se : *' 27... ligjvënësi gjatë ndërhyrjes në një situatë të rregulluar më parë është edhe respektimi i raportit të drejtë mes ndërhyrjes dhe situatës që e ka diktuar atë. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete.....Proporcionaliteti nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera'.*

3.22 Në rastin konkret, ndërhyrja nuk është proporcionale, përse kohë çenohet e drejta e pronës të një personi ka një pritshmëri disa vjeçare për ekzekutimin e vendimit të tij dhe marrjes së kompensimit. Domosdoshmëria ka të bëjë me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u çenohen të drejtat dhe liritë. Në vendimin 1/2013 Gjykata Kushtetuese, duke referuar te Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë ka thënë se : *'36. Një reformë radikale e sistemit ekonomik, politik të një vendi ose gjendja e financave të shtetit mundet të justifikojnë kufizime të forta të të drejtave themelore të individit, megjithatë rrethana të tilla nuk mundet të mbështeten në dëm të parimeve themelore që përshkruajnë Konventën. ... Megjithatë, hapësira e vlerësimit që i është dhënë shtetit, sado e konsiderueshme qoftë, nuk mund të jetë e pakufizuar. Ushtrimi i diskrecionit të shtetit, madje edhe në kontekstin e reformave më komplekse, nuk mundet të sjellë rrjedhoja në kundërshtim me standartet e Konventës*". Gjykata Kushtetuese ka gjithmonë në vëmendje "ekuilibrimin e drejtë të interesave" dhe se masat e marra nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike (Vendim 1/2013, para 42).

3.23 Në vendimin Pilot Manushaqe Puto, Gjykata ka orientuar Qeverinë: *' 113. Në veçanti, ajo thekson ngarkesën tejet të rënduar në buxhetin e shtetit që përfaqëson kompensimi financiar. Përfundimet e mësipërme kërkojnë qartë një rishqyrtim të modaliteteve për pagesën e kompensimit financiar që zbatohet aktualisht. Gjykata nxit autoritetet me prioritet që të fillojnë shfrytëzimin e formave të tjera alternative të kompensimit të parashikuara nga Ligji për Pronësinë i vitit 2004, të cilat eventualisht do të lehtësonin presionin ndaj buxhetit dhe/ose do të paraqisnin mënyra të tjera kompensimi. ... 115. Procesi i kompensimit të ish pronarëve për shkak të Ligjeve për Pronësinë duhet të dallohet nga kompensimi i ish pronarëve në bazë të Ligjit të Legalizimit. Në lidhje me këtë të fundit, Shteti i paditur mund të rishqyrton rritjen e pjesës së kostos që legalizimi i ka sjellë ankuesve në masën që do të ishte i aftë të rregullonte kompensimin financiar të paguar ish pronarëve.* Qeveria nuk ka bërë një vlerësim të drejtë në këtë drejtim, ndërkohë që është e qartë që kishte mundësi të tjera, të cilat duhej të merrnin prioritet veç kompensimit financiar për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare, duke mos kaluar në arbitraritetin sa të çenohet një e drejtë e rëndësishme siç është ajo e pronës dhe e procesit të rregullt ligjor që i referohet ekzekutimit të një vendimi përfundimtar. Ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm dhe ndryshe nga sa është orientuar përmes Vendimit pilot Qeveria i ka kushtuar vëmendje kompensimit financiar referuar nenit 8 të Ligjit. Në vendimin pilot GJEDNJ ka orientuar Qeverinë drejt shfrytëzimit të formave të tjera alternative të kompensimit.³² Gjithashtu Sekretariati në vlerësimin e skemës së kompensimit të paraqitur nga Qeveria përmes Ligjit ka vlerësuar se e ka të pamundur të kuptojë qëllimin e Qeverisë që ka aplikuar një formë të tillë në hierarki për kompensimin dhe ka shfaqur dyshime referuar diskriminimit të

³² Shih Manushaqe Puto k. Shqipërisë, 31 Korrik 2012, para 113

mundshëm që mund të krijohej mes atyre që u është dhënë e drejta e kthimit më parë dhe tani u jepet e drejta e kompensimit.³³

3.24 Qeveria pretendon se ka marrë në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së, por duket qartazi që nuk e ka bërë këtë, përse kohë që në mënyrën e vlerësimit të vendimeve i referohet vendimit Guisso Gallisay k. Italisë apo rastit Vistins & Perepjolkins kundër Letonisë, të cilat janë raste të shpronësimit. GJEDNJ në rastin Vrioni k. Shqipërisë (*just satisfaction*) ka arritur në përfundimin se referuar edhe mënyrës së përlllogaritjes në rastin Driza k. Shqipërisë metoda e përlllogaritjes do të duhej të ishte vlere e pronës në momentin e nxjerrjes së vendimit, por në kushtet që Shqipëria dështoi të kishte një hartë vlere që në vitin 1993, Gjykata në rastin Vrioni iu referua vlerës së pronës në momentin e kompensimit bazuar në hartë vlere që reflekton çmimin e tregut.³⁴ Gjithashtu, Gjykata në mënyrë kategorike përjashtoi aplikimin e metodës së përlllogaritjes të përdorur në rastin Guiso-Gallisay k. Italisë, pasi çështje Vrioni dhe çështje të ngjashme me të nuk ishin çështje shpronësimesh të ndërtesave, apo mënyra të paligjshme të përfitimit të tokës, por kishin të bënin me mospagimin e kompensimit.³⁵

3.25 Në këtë mënyrë është e qartë se qasja e Qeverisë referuar Ligjit 133/2015 është në kundërshtim me jurisprudencën e GJEDNJ referuar më sipër dhe krijon një pasiguri juridike sa i përket pritshmërive në lidhje me të drejtën e kompensimit për vendimet që presin prej vitesh të ekzekutohen. Parimi i sigurisë juridike, përfshin krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka konsoliduar qëndrimin se: *“Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të çënojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme....Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshim sjell pasoja pozitive.”*³⁶

(iii) Rivlerësimi i vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore në lidhje me kompensimin çënon parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit

3.26 Përveç shkeljes së parimit të sigurisë juridike referuar metodologjisë së kompensimit referuar nenit 6, 7 të Ligjit si dhe shkeljes së standartit të vendosur nga

³³ Shih Document H/ Exec (2015)16, para 45, 53 (Vlersimi Sekretariatit).

³⁴ Shih Vrioni k. Shqipërisë (*just satisfaction*) para. 36-37

³⁵ Shih Vrioni k. Shqipërisë, para 34-35.

³⁶ Shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 28.04.2014, para.40

GJEDNJ në vendimmarrjen e saj në çështjet e pronave, përmes këtij rregullimi shkelet dhe një parim i rëndësishëm i bararazisë para ligjit referuar nenit 18 të Kushtetutës. Referuar Relacionit të Ligjit dhe sqarimeve të bëra nga Qeveria para Sekretariatit rezulton se ky Ligj nuk prek vendimet e GJEDNJ dhe të brendshëm përmes të cilave është vendosur një vlerë konkrete për t'u paguar. Fakti që një ishpronar i është drejtuar më parë Strasburgut dhe i është dhënë shpërblimi i drejtë me vendim gjykatë dhe një tjetër akoma nuk ka marrë kompensimin, nuk mund të lejojë ligjvënësin të krijojë një situatë pabarazie, pavarësisht interesit publik që synohet të mbrohet përmes këtij ligji.

(iii) Rivlerësimi i vendimeve përfundimtare administrative/gjyqësore në lidhje me kompensimin cënon të drejtën e pronësnë kuptim të nenit 1 Protokollit 1 i KEDNJ-së.

3.27 Në çështjen Driza kundër Shqipërisë, GJEDNJ arriti në përfundimin se dështimi i vazhdueshëm për t'u paguar kompensimin ankuesve dhe për të njohur të drejtat e tyre të pronësisë çoi në ndërhyrje në të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Pavarësisht nga niveli i gjerë që u jepet shteteve në përcaktimin e asaj që është në interes publik, në veçanti kur kemi të bëjmë me prona të shtetëzuara ose të shpronësuar, Gjykata Evropiane është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se Shtetet dështuan të justifikojnë moszbatimin e vendimeve të gjykatave të brendshme dhe të vendimeve administrative. Dështimi i gjetjes së një baraspeshe të drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtje të të drejtave themelore të individit i lanë ankuesit në një gjendje pasigurie në lidhje me realizimin e të drejtave të tyre të pronësisë (shkelje e nenit 1 Protokollit 1). Në çështjen Maria Atanasiu dhe të Tjerë kundër Rumanisë, Gjykata ka konkluduar se : '... dështimi për të zbatuar një vendim gjykatë, që njeh të drejtën për kompensim, madje edhe aty ku shuma e çmimit nuk është e përcaktuar, përbën ndërhyrje në të drejtën për qëzim të qetë të posedimit, në kuptimin e fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr.1.' Në çështjen Kehaya dhe të tjerët k. Bullgarisë, Gjykata arriti në përfundimin se interesi i publikut nuk mund të konsiderohet si justifikim për kapërcimin e parimit themelor të sigurisë ligjore dhe të drejtat e pronësisë të ankesit.

3.28 Në rastin konkret është e qartë, që zgjidhja e ofruar është duke rishikuar vendimet e dhëna kohë më parë dhe në këtë mënyrë duke cënuar të drejtat e pronësisë si rezultat i vendimeve që i kanë dhënë kthim + kompensim, apo edhe vetëm kompensim. Vlerësimi i vendimit të parë duke përdorur një mënyrë dhe formë të ndryshme kompensimi referuar vlerës së tokës në momentin e shpronësimit, do të thotë të cënosh të drejtën e pronës të fituar përmes një vendimi përfundimtar, të cilin shteti ka dështuar prej vitesh ta ekzekutojë sipas standarteve të kërkuara nga Konventa. Përveç të drejtës së kompensimit pronarët kanë edhe të drejta të tjera që rrjedhin

referuar ligjeve të mëparshme. P.sh, referuar nenit 8/1 /b të ligjit të mëparshëm në trojet e zëna me ndërtime në pronësi të shtetit për të cilat pronarit i është rezervuar e drejta e parablerjes, pronari rezervon të drejtën të paguhet nga shteti për qeranë e truallit të zënë me ndërtim deri në momentin e privatizimit të objektit. Neni 22 apo ndonjë dispozitë tjetër e Ligjit nuk njeh një të drejtë të tillë dhe në këto kushte shuhet e drejta favorizuese e pronarit të njohur përmes një ligji të mëparshëm dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit do të fillojnë të aplikohen dispozitat e tij. Si rezultat, në kuptim të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe KEDNJ-së Ligji në mënyrën e ofruar për kompensimin referuar nenit 6-7 të tij përbën shkelje të nenit 1 Protokolli nr.1 i Konventës.

B. Shkeljet kushtetuese në rregullat e përcaktuara në Ligj në drejtim të trajtimit të dosjeve të patrajuara të pronave.

- (i) *Skema e ofruar përmes këtij Ligji për trajtimin e dosjeve të patrajuara apo ato që do të depozitohen rishtazi pas hyrjes në fuqi të ligjit bie ndesh me parimin kushtetues të sigurisë juridike, të barazisë para ligjit dhe të së drejtës së ankimit.*

3.29 Rregullat në lidhje me trajtimin e kërkesave të patrajuara janë të përcaktuara në Kreun IV, ku përcaktohen rregulla të reja për trajtimin e pronës të ndryshme nga ato të përcaktuara në ligjin nr.9235. Ligji në nenin 21 të tij përcakton të drejtën e subjektit të shpronësuar për t'u kompensuar në pronën e tij referuar metodologjisë të përcaktuar në nenin 6, 7 të Ligjit të trajtuar më sipër, ndryshe nga sa përcaktonte ligji i mëparshëm që njihte të drejtën e kthimit të pronës dhe kompensimit të pronës në momentin e dhënies së vendimit. Në këtë qasje Qeveria dhe si rrjedhojë legjislatori ka krijuar një pasiguri juridike në lidhje me pritshmëritë e subjektit të shpronësuar, i cili pret të kompensohet në tokën e vet, pasi më parë të bëhet vlerësimi për tokën e tij referuar llojit të pronës në momentin e shpronësimit. Kjo qasje jo vetëm që krijon pasiguri juridike referuar edhe pritshmërive legjitime, por nga ana tjetër shkel edhe barazinë e shtetasve para ligjit, duke diskriminuar subjektet të cilët nuk kanë arritur të marrin në kohë jo për faj të tyre një vendim përfundimtar nga AKKP. Subjektet e shpronësura të cilët janë pajisur me vendim para dy viteve u është rezervuar e drejta e kthimit të pronës sipas kërkesës së tyre, duke iu referuar gjendjes aktuale të saj si pasojë e zhvillimit të tokës, ndërkohë një subjekt tjetër diskriminohet duke iu rezervuar veç e drejta e kompensimit në tokën e vet. Sekretariati i Komitetit të Ministrave ka hedhur dyshime në lidhje me mundësinë e diskriminimit në raste të tilla. Gjithashtu, subjekte të tilla diskriminohen edhe në drejtim të përfitimit të të drejtave të tyre të njohura sipas ligjit nr. 9235, si p.sh e drejta e qerasë së truallit deri në momentin e privatizimit etj. Gjykata Kushtetuese në

jurisprudencën e saj ka arritur në përfundimin se: *‘Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive’*³⁷

3.30 Në lidhje me vlerësimin e pronës, mënyrës së kompensimit dhe formave të kompensimit referuar nenit 6, 7,8 të Ligjit i qëndrojnë komentete në pikën A(i), (ii).

3.31 Ligji në nenin 29 të tij bie ndesh me nenin 43 të ligjit sa i takon të drejtës së ankimit. Çdokush ka të drejtën që të ankojë në një Gjykatë me të lartë kundër një vendimi gjyqësor. Në rastin konkret, përsa kohë gjykata shqyrton çështje të themelit, është e domosdoshme që pala të rezervojë të drejtën të apelojë atë vendim në një shkallë më të lartë. Gjykata e Lartë është gjykatë e ligjit dhe si e tillë nuk mund të investohet në fakte të çështjes.

(ii) Shkelja e procesit të rregullt ligjor dhe fuqia prapavepruese e ligjit si cënim i sigurisë juridike

3.32 Qeveria pasi ka ndaluar pa shkak në dy vite shqyrtimin e kërkesave të aplikantëve, të cilët kanë pritur prej vitesh të realizojnë të drejtën e tyre, tashmë ka vendosur të ndryshojë rregullat e trajtimit të pronës për subjekte të cilat kanë ndoshta edhe 10 vite që kanë paraqitur kërkesën e tyre. Referuar nenit 15 të ligjit të mëparshëm Drejtori i Përgjithshëm i AKKP kishte detyrë që në tre muaj të nxirrte vendim lidhur me trajtimin e pronës, duke vendosur sipas rastit njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës. Janë rreth 9000 vendime të deklarura para Sekretariatit të Komitetit të Ministrave, ndërkohë që referuar raportit të Komisionit të Ligjeve ky numër është rritur në 10.131 dhe vazhdon të rritet. Të gjitha këto subjekte kishin pritshmëritë të trajtoheshin sipas dispozitave të ligjit 9235, ndërkohë që Qeveria pasi ka provokuar një proces të parregullt ligjor sa i takon përzgjatjes së procedurave administrative dhe pas sorollatjes së tyre me vite, tani u ndryshon dhe *‘rregullat e lojës’*. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 9, datë 26.02.2007 ka vlerësuar se “... *besimi ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht, ose të jetojë me frikë nga ndryshueshmëria e akteve juridike...*”. Gjithashtu, sic është cituar më lart legjislacioni duhet të ketë rregullime në kahe positive dhe se “... *nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion*”.

3.33 Këtyre aplikantëve iu është mohuar një proces i rregullt ligjor dhe Qeveria për të mbuluar shkeljen përmes rregullimit ligjor pretendon ta fshehtë këtë fakt dhe për më tepër të përcaktojë një afat jo të arsyeshëm kohor prej tre vitesh të tjera për të përmbyllur trajtimin e kërkesave që nuk janë arritur të trajtohen ndoshta prej 10 vitesh. Në çështjen Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë, Gjykata ka arritur në konkluzionin se përzgjatja e procedurave në cdo instancë të juridiksionit përbën

³⁷ Shih Vendime të Gjykatës Kushtetuese, nr. 34, dt.20.12.2005; nr.9 dt. 26.2.2007; nr.24, dt.12.11.2008; nr.4 dt.12.2.2010; nr. 31 dt. 18.6.2010; nr.43, datë 6.10.2011

proces të parregullt ligjor referuar nenit 6/1 të Konventës.³⁸ Në çështjen Bici Kundër Shqipërisë Gjykata ka konkluduar se nuk ka arsye që të përzgjaten procedurat nga organet administrative dhe se Shteti ka barrën të organizojë sistemin e tij të brendshëm në një mënyrë të tillë që autoritet shtetërore të realizojnë një proces të rregullt ligjor referuar nenit 6 të Konventës.³⁹ Gjykata, ka patur në konsideratë draft-ligjin e përgatitur nga Qeveria dhe përmes këtij vendimi ka dashur t'i japë Qeverisë mesazhin e qartë se përmes Ligjit të ri po prodhon shkelje, ndërkohë që nuk ka gjetur një rregullim të brendshëm për shpërbimin e aplikantëve si rezultat i shkeljeve të prodhuara prej vitesh për shkak të përzgjatjes së procedurave në trajtimin e pronave.

3.34 Në vitin 2004, afati i funksionimit të AKKP u shty deri në 30.04.2015, duke u justifikuar me shtimin e numrit të dosjeve në AKKP dhe se kërkonin më tepër kohë për trajtimin e dosjeve, por në fakt autoritetet nuk nxorren asnjë vendim gjatë kohës së shtyrë me ligj.⁴⁰ Në 2015 sërish autoritetet kanë kërkuar shtyrje afati deri 30.10.2015, duke pretenduar trajtimin e dosjeve që gjenden në AKKP, ndërkohë që kanë pranuar se vazhdojnë të pranojnë dosje të reja.⁴¹ Autoritetet jo vetëm se nuk kanë trajtuar asnjë pronë, ndërkohë dhe as nxjerrë vendim, por kanë marrë kohën për të paraqitur një Ligj të ri për trajtimin e pronës dhe kanë parashikuar se dosjet që janë në proces do të trajtohen sipas këtij ligji, duke i dhënë në këtë mënyrë fuqi prapavepruese Ligjit. Ndalimi i fuqisë prapavepruese të ligjit është një element përbërës i parimit të sigurisë juridike. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen mes subjekteve të ndryshme të së drejtës. Duke u dhënë akteve fuqi prapavepruese, sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, do të cënohet parimi i sigurisë juridike dhe rrjedhimisht do të shkelet parimi i shtetit të së drejtës.⁴² Është e qartë që përmes ligjit që i jepet fuqi prapavepruese shkelet parimi i sigurisë juridike, por në asnjë rast nuk justifikohet për asnjë lloj interesi publik referuar rastit konkret⁴³. Legjislatori nuk mund të ndryshonte ligjin material të pronës përsa kohë çështjet janë në shqyrtim nga një organ administrativ, i cili ka kompetencën të nxjerrë vendime kuazi-gjyqësore që përbëjnë tituj ekzekutiv. Legjislatori mund të përcaktonte rregulla të reja për aplikimet e depozituara rishtazi. Një qasje e tillë është në shkelje të parimeve kushtetuese.

³⁸ Shih Vendimi i GJEDNJ-së Luli dhe të Tjerë kundër Shqipërisë, para 96

³⁹ Shih Bici k. Shqipërisë (nr.5250/07), dt.3 Dhjetor 2015, para .44

⁴⁰ Aneks XI- Relacioni i Projekt ligjit “ Per disa ndryshime ne ligjin nr.9235, dt.29.07.2004” Per kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar. (Ligj 49/2014)

⁴¹ Aneks XII-Relacion i projekt-ligjit “ Per disa ndryshime ne ligjin nr.9235, dt. 29.07.2004” Per kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar”(Ligj 47/2015)

⁴² Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007, Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, dt.11.07.2006

⁴³ Shih, Ky material para-3.18-3.28

IV. PEZULLIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT NR.133/2015

4.1 Në nenin 3 të Ligjit 133/2015 përcaktohet :

“ 1. Ky Ligj vepron për të gjitha kërkesat, të cilat janë në shqyrtim në AKKP, në ditën e hyrjes në fuqi të tij, si edhe mbi të gjitha ato kërkesa, të cilat do të paraqiten brenda afateve të këtij ligji, sa i takon njohjes së të drejtës së pronës.

2. Gjithashtu, ky ligj i shtrin efektet, sa i takon vlerësimit financiar për:

a) ekzekutimin e të gjitha vendimeve, të cilat nuk janë zbatuar, për njohjen e së drejtës së kompensimit, të dhëna nga organet administrative ose gjyqësore në vendin tonë;

b) çështjet që janë në shqyrtim në gjykatat e të gjitha niveleve, në Gjykatën e Lartë, si edhe në GJEDNJ, sa i takon vlerësimit financiar të tyre.”

4.2 Duke iu referuar nenit 45 të ligjit nr 8577/2000 ”Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” në paraqitjen e kësaj kërkesë vlerësohet se zbatimi i ligjit nr. 133/2015 do të sjellë pasoja, që prekin jo vetëm interesat shtetërorë dhe kombëtarë, por në destinacion të fundit prekin interesat e individëve.

Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese nuk ka përcaktuar kritere nga duhet të niset Gjykata, ndërkohë që jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar disa kritere si:

- (i) ekzistenca e një dyshimi serioz për kushtetutshmërinë e normës juridike që shqyrtohet;
- (ii) urgjenca që paraqet masa e pezullimit për shkak të shmangies së një dëmi serioz dhe të pariparueshëm që mund t’u shkaktohet interesave të përgjithshëm shtetërorë, shoqërorë ose të individëve.

4.3 Në lidhje me ekzistencën e një dyshimi serioz për kushtetutshmërinë e normës juridike që shqyrtohet duhet nënvizuar se zbatimi i këtij ligji çënon rëndë standartet kushtetuese dhe të KEDNJ-së, përmes të cilave janë mirëpërcaktuar, zbatimi i vendimeve të formës së prerë; e drejta e posedimit qetësisht të pronës; siguria juridike; procesi i rregullt ligjor etj. Përmes rregullimeve ligjore do të cënohen vendime të formës së prerë, duke bërë vlerësimin e vendimeve të mëparshme duke iu referuar llojit të pronës në momentin e shpronësimit. Ky Ligj përmes të cilit pretendohet të ndërtohet një skemë efektive për zgjidhjen e problemit të pronave në Shqipëri është vënë në dyshim edhe nga vetë Sekretariati i Komitetit të Ministrave të këshillit të Evropës. Ky Ligj ka fuqi prapavepruese, pasi të gjitha dosjet e

patrajuara prej vitesh do të trajtohen përmes këtij Ligji. Dhe jo vetëm në AKKP, por edhe në të gjitha Gjykatat në R.SH-së, përfshirë edhe GJEDNJ.

4.4 Zbatimi i këtij ligji, nën arsyetimin e të gjitha argumenteve të parashtruara në këtë kërkesë, potencialisht krijon situatën e dobësimit të pozitës së pronarëve të cilët tashmë kanë një vendim përfundimtar të formës së prerë të cilin presin prej vitesh që të ekzekutohet. Ndërhyrja e Shtetit përmes këtij Ligji nuk është proporcionale, por përkundrazi është arbitrare dhe cënon rëndë standartet e Konventës dhe të Kushtetutës të R.SH-së, duke cënuar drejtëpërdrejt të drejtat e pronarëve dhe subjektet e tjera që janë në pritje prej vitesh të trajtimit të kërkesës së tyre për kthim/kompensimin e pronës. Referuar nenit 41 dhe 181 të Kushtetutës, Legjislatori ka bërë një rregullim të ri në lidhje me pronat e konfiskuara/shpronësuar gjatë rregjimit komunist, duke mos njohur konceptin e ‘kthimit’ dhe duke i dhënë prioritet kompensimit financiar, ndërkohë që ligji i vitit 2004 i jepte prioritet formave të tjera të kompensimit apo mekanizmave të tjerë nëse nuk realizohej ‘kthimi’, gjë e cila është vlerësuar pozitivisht në atë kohë nga partnerët ndërkombëtarë. Vendimi pilot për Shqipërinë ka pritshmëri të ndryshme nga sa përcaktohet në këtë ligj.

4.5 Duke e ballafaquar këtë Ligj me çfarë kërkohet nga GJEDNJ përmes vendimit pilot Manushaqe Puto & të Tjerë kundër Shqipërisë, si dhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me padrejtësitë gjatë rregjimit komunist lidhur me pronat në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, është e qartë se në asnjë rast nuk është respektuar vendim-marrja e Gjykatës. Për të justifikuar Ligjin, në relacionin e projekt-ligjit dhe në raportin e Komisionit të Ligjeve është manipuluar duke iu referuar vendimeve të GJK apo të GJEDNJ që nuk janë ato të duhurat dhe që nuk ofrojnë zgjidhjet e kërkuara.

4.6 Situata praqitet tepër urgjente, pasi menjëherë ATP do të fillojë të bëjë vlerësimin e vendimeve të kaluara, duke nxjerrë vendime dhe në këtë mënyrë duke përfshirë subjektet në proces. Gjykatat do të jenë të detyruara që gjatë shqyrtimit të çështjeve t’i referohen Ligjit që tashmë ka hyrë në fuqi. Nga ana tjetër, ATP do të nxjerrin vendime në lidhje me pronat e patrajuara deri më sot dhe do t’i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në këtë Ligj. Kjo situatë do të jetë e pariparueshme dhe do të krijojë sorollatje dhe kosto për pronarët apo subjektet që presin të trajtohen, duke krijuar kështu shkelje të reja referuar Konventës. Sipas këtij Ligji, edhe GJEDNJ detyrohet t’i referohet atij Ligji, paçka se kërkesat janë paraqitur kur në fuqi ishte një Ligj shumë i ndryshëm nga ky i fundit. Sipas Vendimit Pilot procesi i vendim-marrjes për mënyrën dhe llojin e kompensimit që do të jepet kërkon transparencë dhe efikasitet maksimal, me synim rritjen e besimit të publikut. Skema që do të ndërtohet duhet të jetë e mirëstudiuar dhe të mos çënojë standartin e kërkuar nga Gjykata. Në rast të kundërt, shteti shqiptar do të vazhdojë të penalizohet.

4.7 Presidenti i Republikës, në bazë të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, kërkon pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 133/2015 deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese. Në paraqitjen e kësaj kërkesë vlerësohet se zbatimi i ligjit nr. 133/2014 mund të sjellë pasoja, që prekin jo vetëm interesat e individëve, por edhe interesat shtetërorë dhe kombëtare, përsa kohë çënohen rëndë parime të rëndësishme të sanksionuara në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

V. KONKLUZION

Në përfundim të të gjitha argumenteve të parashtruara, Presidenti i Republikës kërkon nga Gjykata Kushtetuese:

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i ligjit nr. 133/2015 “ Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”

Me respekt,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

BUJAR NISHANI